



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



# KOMITETI DREJTUES

## (rolet dhe përgjegjësitë)

2024

*Mohim përgjegjësie: Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë dokument nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.*

# KOMITETI DREJTUES

## I. Dispozitat fillestare: qëllimi, parimet dhe përgjegjësitë

Ky dokument themelon komitetin drejtues të koalicionit kundër korruptionit, i përbërë nga shoqatat e biznesit. Përmes këtij dokumenti përshkruhen rolet, përgjegjësitë dhe struktura e "Komititet Drejtues". Komiteti shërben si mekanizëm për zbatimin e "Kodit të Bizneseve Kundër Korruptionit (KBKK)" dhe "Udhëzuesit për Zbatimin e Kodit të Bizneseve Kundër Korruptionit (UKBKK)", të cilët janë komponentë përbërëse të projektit "Integriteti i Sektorit Privat: korruptioni nga ana e ofertës". Ky projekt financohet nga aktiviteti i USAID-it Integriteti i Komunave në Kosovë dhe zbatohet nga Instituti Riinvest.

Organizatat e mëposhtme (rendita në mënyrë alfabetike) janë themeluese të koalicionit kundër korruptionit (në tekstin e mëtejmë Koalicioni)

- I. Klubi i Prodhuesve të Kosovës
- II. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë
- III. Oda Ekonomike e Kosovës
- IV. Oda Ekonomike Gjermano - Kosovare
- V. Rrjeti CSR Kosova
- VI. Shoqata ESNAF

### Neni I Qëllimi i Komitetit Drejtues

Kjo marrëveshje është bazë për themelin e Komitetin Drejtues për zbatimin e KBKK-së dhe UKBKK-së. Qëllimi kryesor i komitetit është të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit të biznesit në Kosovë për rëndësinë e zhvillimit të parimeve etike dhe rritjes së integritetit të sektorit privat për të zgjegjësuar korruptionin dhe dhënien e mitos.

### Neni 2 Parimet e përgjithshme të Komitetit Drejtues

1. Komiteti Drejtues do të punojë për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e integritetit dhe parimeve etike në sektorin privat, siç përshkruhet në KBKK dhe UKBKK, të nënshkruar nga asocacionet e bizneseve dhe anëtarët e tyre.
2. Komiteti Drejtues do të zhvillojë aktivitete avokuese, kërkimore, dhe edukative në emër të anëtarëve të tij, për të identifikuar sfidat aktuale dhe promovuar zbatimin e parimeve etike në sektorin privat.
3. Gjatë kryerjes së aktiviteteve, Komiteti Drejtues do të respektojë ligjet dhe rregulloret e Republikës së Kosovës, marrëveshjet e brendshme ndërmjet anëtarëve dhe praktikat më të mira të një shoqërie të hapur dhe demokratike.
4. Komiteti Drejtues do të kryejë aktivitetet në mënyrë transparente, duke përmirësuar imazhin e anëtarëve të tij.
5. Kryesimi i Komitetit Drejtues do të bëhet me rotacion në baza vjetore me vendim të Komitetit Drejtues.

### **Neni 3 Roli dhe përgjegjësitë**

Qëllimi i Komitetit Drejtues do të jetë mbajtja, ushtrimi dhe zbatimi i detyrave dhe detyrimeve kontraktuale për zbatimin e KBKK-së dhe UKBKK-së. Anëtarët e Komitetit Drejtues do të kryejnë përgjegjësitë e tyre siç përcaktohet në këtë dokument:

1. Komiteti Drejtues mbikëqyr dhe menaxhon zbatimin e KBKK-së dhe UKBKK-së dhe aktivitetet përkatëse në emër të Koalicionit Kundër Korrupsionit.
2. Komiteti Drejtues monitoron performancën, rezultatet dhe ndikimin e KBKK-së dhe UKBKK-së.
3. Komiteti Drejtues shqyrton strukturën dhe praktikat e qeverisjes së KBKK-së dhe UKBKK-së.
4. Komiteti Drejtues vendos për rekrutimin, përzgjedhjen dhe integrimin e anëtarëve të rinj të Komitetit Drejtues.
5. Organizatat dhe partnerët individualë të Komitetit Drejtues mund të ftohen të jasin kontributin e tyre për hartimin e dokumenteve si pjesë e grupit punues, nëse ekspertiza e tyre konsiderohet e dobishme për cilësinë e dokumenteve përfundimtare.
6. Aktivitetet e Komitetit Drejtues mund të plotësohen me aktivitete individuale të anëtarëve që lidhen drejtpërdrejt me qëllimin e Koalicionit KK.
7. Anëtarët e Komitetit Drejtues do ta përfaqësojnë komitetin në ngjarje publike dhe mediatike sipas nevojës, duke promovuar pikëpamjet dhe propozimet e Koalicionit KK.
8. Anëtarët e Komitetit Drejtues do të ofrojnë komente dhe sugjerime për punët që janë me interes për anëtarët e tjerë për publikim.

### **Neni 4 Pritshmëritë e anëtarëve pjesëmarrës**

Anëtarët e Komitetit Drejtues pritet të kontribuojnë aktivisht përmes udhëheqjes, ekspertizës dhe kohës së tyre për të mbështetur Koalicionin KK, në arritjen e qëllimeve të tij. Çdo anëtar i Komitetit Drejtues pritet të:

1. Përgatitet dhe merr pjesë në takimet e Komitetit Drejtues, duke përfshirë shqyrtimin e agjendave, materialeve informuese dhe procesverbaleve.
2. Përfaqësoj vlerat e shoqatës së tyre, të punoj dhe shfrytëzoj rrjetëzimin e tyre për të çuar përpara qëllimet e Koalicionit KK.

## **II. Anëtarësia**

### **Neni 5 Organi i Komitetit Drejtues**

Anëtarët e Komitetit Drejtues duhet të zotohen ndaj misionit dhe punës së Koalicionit KK, të kenë integritet dhe vlerat më të larta personale dhe profesionale dhe të janë liderë me njohuri strategjike në fushat e tyre përkatëse.

### **Madhësia e Komitetit Drejtues**

Komiteti Drejtues fillimisht përfshin anëtarët individualë që kanë nënshkruar KBKK-në dhe UKBKK-në.

## **Mandati**

Komiteti Drejtues ka një mandat 2-vjeçar me mundësi vazhdimi edhe për një mandat tjetër.

### **Emërimet e vazhdueshme**

Komiteti Drejtues mund të emërojë anëtarë të rinj me miratimin e shumicës së thjeshtë të anëtarëve ekzisutes. Çdo anëtar i ri do të bëhet pjesë e Koalicionit KK pas aprovimit formal nga Komiteti Drejtues.

### **Dorëheqja**

Çdo anëtar/e mund të japë dorëheqje në çdo kohë duke e njoftuar Kryesuesin/en e Komitetit Drejtues.

### **Largimi i anëtarëve nga Koalicioni KK**

Komiteti Drejtues mund të vendosë largimin e anëtarëve në rast se një anëtar nuk merr pjesë në trimbledhje radhazi të Komitetit Drejtues.

### **Kompensimi**

Anëtarët e Komitetit Drejtues nuk do të kompensohen në cilësinë e anëtarëve të komitetit.

## **Neni 6**

### **Vendimmarrja**

1. Komiteti Drejtues është organi më i lartë drejtues. Ai përbëhet nga të gjithë anëtarët bashkëthemelues.
2. Çdo anëtar/e ka një votë në Komitetin Drejtues. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e Kryesuesit të Komitetit Drejtues është vendimtare.
3. Vendimet për çështjet e avokimit dhe kërkimeve merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
4. Vendimet për emërimin e përfaqësuesve të Komitetit Drejtues bëhen me shumicë të thjeshtë të anëtarëve.
5. Komiteti Drejtues mund të shpërndahet me vendim të dy të tretave të anëtarëve.
6. Me përashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në marrëveshje ose në këtë dokument, çdo veprim i ndërmarrë nga shumica e anëtarëve të Komitetit Drejtues të pranishëm në një mbledhje ku ka kuorum, do të konsiderohet si veprim i Komitetit Drejtues.

## **III. Takimet**

### **Neni 7**

### **Organizimi i takimeve**

Komiteti Drejtues do të takohet të paktën katër (4) herë çdo vit. Komiteti Drejtues mund të ndryshojë numrin e takimeve në vit bazuar në dinamikat e agjendës ose ndonjë çështje të rëndësishme.

### **Agjenda**

Kryesuesi/ja i/e Komitetit Drejtues harton agjendën konkrete për çdo mbledhje. Çdo anëtar i Komitetit Drejtues mund të kërkojë që një çështje të përfshihet në rendin e ditës në atë mbledhje.

## **Njoftimi**

Kryesuesi/ja do të informojë çdo anëtar të komitetit për datën, vendin dhe orën e mbledhjeve të Komitetit Drejtues të paktën 10 ditë pune para takimit. Kryesuesi/ja do t'i sigurojë Komitetit Drejtues materiale të shkruara që janë të rëndësishme për të kuptuar çështjet që do të diskutohen në takimin e ardhshëm.

## **Kuorumi**

Shumica e anëtarëve aktualë të Komitetit Drejtues do të përbëjnë kuorumin.

## **Votimi**

Çdo anëtar i pranishëm në takim do të ketë një votë.

## **Procesverbalet**

Komiteti Drejtues do të mbajë dhe të ruajë procesverbalet e takimeve.

## **IV. Komunikimi dhe registrat**

### **Neni 8**

#### **Komunikimi**

Të gjitha komunikimet e Komitetit Drejtues, duke përfshirë njoftimet, miratimet dhe shpërndarjet e materialeve, mund të dërgohen me email ose forma të tjera të komunikimit elektronik.

#### **Registrat**

Kryesuesi/ja i/e Komitetit Drejtues do të mbajë shënimë në lidhje me aktivitetet e Komitetit Drejtues, duke përfshirë, për shembull, procesverbalet e mbledhjeve dhe dokumentet që u shpërndahen anëtarëve të Komitetit Drejtues.

## **Deklaratat Publike**

Komiteti Drejtues mund të hartoj dhe të bëjë deklarata publike në përputhje me misionin e Koalicionit KK dhe këtij dokumenti. Komiteti Drejtues nuk mund të bëjë asnjë deklaratë që mund të interpretohet si deklaratë e aktivitetit të USAID-it Integriteti i Komunave në Kosovë. Ne inkurajojmë anëtarët e Komitetit Drejtues që të avokojnë për Koalicionin KK, por jo të komunikojnë me media ose të bëjnë komunikime të tjera publike në emër të aktivitetit të USAID-it Integriteti Komunal në Kosovë.

## **I. Dispozitat e Përgjithshme**

### **Neni 9**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

Ky dokument mund të ndryshohet ose shfuqizohet dhe dispozita të reja mund të miratohen nga Komiteti Drejtues. Çdo ndryshim duhet të jetë në përputhje me KBKK-në.


Ndryshimet dhe plotësimet në këtë dokument mund të bëhen me iniciativën e të paktën një të tretës së nënshkruesve dhe miratimi i tyre bëhet me pëlgimin e të gjithë nënshkruesve.

Lista e nënshkruesve të këtij Komiteti Drejtues është e hapur për të gjitha shoqatat e biznesit nga sektori privat që pranojnë dispozitat e këtij dokumenti dhe shprehin gatishmërinë për të qenë pjesë e tij dhe për ta nënshkuar atë. Shoqatat e biznesit mund të kushtëzojnë/inkurajojnë bizneset e reja që dëshirojnë të anëtarësohen në shoqatë që të nënshkruajnë paraprakisht Kodin e Bizneseve Kundër Korruptionit.

Listë e anëtarëve të Komitetit Drejtues:


- Oda Ekonomike e Kosovës

Samir Lleshi, anëtar



- Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë

Pëllumb Shala, anëtar



- Oda Ekonomike Gjermano - Kosovare

Nora Hasani, anëtare



- Klubi i Prodhuesve të Kosovës

Arta Pllana, anëtare




- Rrjeti CSR Kosova

Zana Bajrami, anëtare



- Shoqata ESNAF

Afrim Rada, anëtar



Prishtinë, 20 Qershor 2024

